




Deklaratat e analizuara:

14 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2004 deri Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2017




Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 6.5 herë.

+ 2,124,101 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Cash



Pasuritë e Luajtshme



Pasuritë e Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	12,097,847	60.5%
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	6,498,487	32.5%
Mësimdhënia	755,000	3.8%
Të ardhura të tjera	633,756	3.2%
Total	19,985,090	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

13 Pa Probleme
1 Me Probleme

Subjekti Elbana Lluri në vitin 2016 rezultoi me burime të pamjaftueshme financiare për të mbuluar blerjen e një apartamenti në Vlorë, pavarësisht burimeve të deklaruara. Diferenca negative është 1,866,089 lekë.

Në vitin 2009, subjekti deklaroi kredi bankare pranë Emporiki Bank në shumën 25,000 euro, por nuk deklaroi qëllimin e kësaj kredie.

Në vitin 2011 është deklaruar një apartament me sipërfaqe 125m² në bashkëpronësi me bashkëshortin Gerd Hoxha me çmim blerjeje prej 6,500,000 lekë. Pjesa takuese e apartamentit prej 50% i është dhuruar gjyqtarës Elbana Lluri nga motra dhe kunati i saj.

Në vitin 2012, ky apartament deklarohet i rivlerësuar në shumën 23.750.000 lekë - lidhur me këtë proces nuk janë deklaruar shpenzime rivlerësimi.

Në 2017 është deklaruar pakësimi i një depozite në BKT në shumën 1,500 euro, por në asnjë nga deklaramet e mëparshme nuk deklarohen likuiditete në bankë.

Në vitin 2011, subjekti deklaroi marrjen e 25 mijë eurove hua nga prindërit, e cila deklarohet si burim për shlyerjen e plotë të kredisë së marrë në Emporiki Bank.